



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 114 datë 27-11-2025

“MBI PËRFAQËSIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NË HARTIMIN E PROJEKT-RREGULLORES “PËR ADMINISTRIMIN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA DHE MASAT NË RASTET E MOSBANIMIT OSE MOSSHFRYTËZIMIT PËR BANIM”.

Këshilli i Bashkisë Korçë , në mbledhjen e tij të sotme, bazuar në ligjin 139/2015 "Për Vetëqëverisjen Vendore", i ndryshuar neni 54 , gërma (a), si dhe në rregulloren "Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Bashkiak Korçë", shkresës me nr.12101 prot datë 17.11.2025 nga Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale ,

VENDOSI:

1. Anëtarët e Këshillit Bashkiak që do të jenë pjesë e grupit të punës të përbashkët me ekzekutivin për të asistuar në hartimin e projekt/rregullores për administrimin e banesave sociale me qira, u propozuan dhe u miratuan nga këshilli anëtarët si më poshtë;
 - **Z.Kristiano Koçibelli**
 - **Znj.Edlira Mitre**
 - **Z.Lazjon Petri**
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 26 vota
Vota Pro 26
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 2
Zbardhur më datë 27-11-2025

KRYETARË

Ana Verushi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E STREHIMIT SOCIAL DHE MENAXHIMIT TË BANESAVE SOCIALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

Datë..../...../2025.

RELACION SHPJEGUES

Mbi

Përfaqësimin e Këshillit Bashkiak në hartimin e projekt-rregullores “Për administrimin e banesave sociale me qira dhe masat në rastet e mosbanimit ose mosshfrytëzimit për banim”.

I. Baza ligjore dhe qëllimi.

Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, parashikohet se “Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton rregulloren për mënyrën e funksionimit të entit menaxhues, si dhe për kontrollin dhe mbikëqyrjen e këtij të fundit.”

Gjithashtu, në zbatim të detyrës së lënë nga Kryetari i Bashkisë Korçë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës **25.09.2025**, lidhur me përgatitjen e një **projekt-rregulloreje për administrimin e banesave sociale me qira**, propozohet fillimi i punës për hartimin e këtij akti nënligjor vendor.

Qëllimi i rregullores është **rregullimi i situatave** të cilat nuk janë parashikuar drejtpërdrejt në ligj, në kuptim të zgjidhjes së njëanshme të kontratës nga qiradhënësi, por që ndikojnë në administrimin e fondit të banesave sociale, me theks të veçantë tek:

- **Mosbanimi ose mosshfrytëzimi i banesës për banim**, pavarësisht pagesës së qirasë.
- **Përdorimi i banesës nga persona të tretë** që nuk janë pjesë e kontratës.
- **Largimi i përhershëm i familjeve përtej territorit të Bashkisë**, pa njoftuar organin administrues.

Këto raste janë evidentuar në praktikën e administrimit të fondit të banesave sociale dhe kërkojnë **rregullim të qartë dhe procedura administrative të unifikuara**.

II. Nevoja për bashkëpunim ndërsektorial.

Duke qenë se çështja ka karakter **social, administrativ dhe ligjor**, hartimi i rregullores kërkon një qasje të balancuar ndërmjet respektimit të të drejtave të përfituesve dhe mbrojtjes së interesit publik në administrimin e pasurisë bashkiake.

Për këtë arsye, propozohet **ngritja e një grupi pune ndërsektorial**, me përfaqësues nga:

- **Drejtorja e Strehimit Social,**
- **Drejtorja Juridike,**
- **Këshilli Bashkiak,**

Në lidhje me përfaqësimin e Këshillit Bashkiak propozojmë **jo më pak se tre (3) këshilltarë**. Çmohet kontributi i cdo këshilltari/e që ka vullnet për të kontribuar.

Ky grup do të ketë për detyrë:

1. Hartimin e draftit të projekt-rregullores;
2. Konsultimin paraprak me strukturat përkatëse dhe shqyrtimin e praktikave ekzistuese;
3. Paraqitjen e versionit përfundimtar për konsultim publik dhe miratim në Këshillin Bashkiak.

III. Koha fizike për hartimin e projekt-rregullores dhe organizimi i punës.

Duke marrë në konsideratë kompleksitetin e temës dhe përfshirjen e disa strukturave institucionale, **përcaktimi i kohës fizike** për punën e grupit është thelbësor për arritjen e një produkti cilësor dhe të zbatueshëm.

Kohëzgjatja e rekomanduar për procesin është **deri në 6 javë pune efektive**, e ndarë në këto faza:

Faza	Përmbajtja	Kohëzgjatja e rekomanduar
Analiza paraprake	Shqyrtimi i bazës ligjore, praktikave aktuale dhe problematikave të evidentuara	1 javë
Hartimi fillestar	Përgatitja e draftit të parë nga grupi i punës	2 javë
Rishikimi ligjor dhe harmonizimi	Përfshirja e komenteve të Drejtorisë Juridike dhe strukturave përkatëse	1 javë
Konsultimi paraprak dhe finalizimi	Diskutim ndërsektorial dhe përgatitja për konsultim publik	2 javë

Drejtorja e Strehimit Social dhe MBS do të ketë përgjegjësinë për **koordinimin e afateve, organizimin e mbledhjeve, dhe raportimin** për ecurinë e procesit .

Kjo nismë synon të përmirësojë **transparencën dhe efikasitetin** në administrimin e fondit të banesave sociale, të garantojë **trajtim të drejtë dhe të barabartë** për të gjithë përfituesit dhe të krijojë një **bazë të qartë ligjore** për menaxhimin e rasteve të mosbanimit dhe përdorimit të paligjshëm për sektorin e menaxhimit të banesave sociale.

Për sa më sipër kërkojmë përfaqësimin e **Këshillit Bashkiak** në grupin e punës për hartimin e projekt-rregullores “Për administrimin e banesave sociale me qira dhe masat në rastet e mosbanimit ose mosshfrytëzimit për banim” me anëtarë të cilët do të zgjidhen dhe miratohen me vendim të posaçëm të tij.

Drejtorja E Strehimit Social Dhe Menaxhimit Të Banesave Sociale

DREJTORE

Mirela Balli